



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2020:011767

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05668160

**P.nr..../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurës Sh..... K..... B..... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPPRK-së, te akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II-nr.152/20 të datës 25.01.2020, duke vepruar sipas detyrës zyrtare me datë ..... bie këtë:

**A K V E N D I M**

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II-nr.152/20 të datës 25.01.2020.

**PUSHOHET** procedure penale ndaj të akuzuarës Sh..... K..... B....., e lindur me ..... në Pejë, me banim në P... rr. L... D....., nga i ati Xh..... dhe nëna H.... e gjinisë M....., me nr. personal ....., e nacionalitetit Shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 216 par. 1 të KPRK-së

E dëmtuara K.... sh.a me seli në Pejë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

**A R S Y E T I M**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Përgjithshme ka ngritur aktakuzën PP/II-nr.152/20 të datës 25.01.2020 penale ndaj të pandehurës Sh..... K..... B..... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPPRK-së.

Gjykata me datën ....., ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor e cila nuk është mbajtur rre me mungesë të të pandehurës, ndërsa me datën ..... nga gjykata është lëshuar urdhërese për sigurimin e informacionit për të pandehurën. Me datën ..... ndaj të pandehurës ka lëshuar urdhër arrest.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka gjetur se në këtë çështje penale ka arritur afati i parashkrimit absolut i ndjekjes penale dhe atë me datë ..... ndaj të akuzuarës Sh..... K..... B.....

Sipas aktakuzës i pandehuri është akuzuar për veprën penale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së për të cilëve veprën është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 vit, e për të cilën veprën penale sipas kodit penal në bazë të të cilit është ngritur aktakuza afati absolut i parashkrimit të ndjekjes penale do të arrihet me datë .....

Prandaj edhe sa i përket dënueshme risi kodit i ri ../-... ka paraparë dënim me të rendë se sa kodit ../-... që është dashur të aplikohet në rastin konkret, e po ashtu sa i përket kohës së parashkrimit kodit ../-... përkatësisht neni 106 afatet e parashkrimit të ndjekjes penale i ka përcaktuar me të shkurtra.

Prandaj gjykata sipas detyrës zyrtare ka aplikuar Kodin e aplikueshëm penale në kohën e kryerjes së veprës penale (.....) ngase me dispozitën ligjore të nenin 3 të KPRK-së është përcaktuar se ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ( zbatimi i ligjit me të favorshëm).

Me dispozitën ligjore të nenit 359 të KPPRK-së është përcaktuar se: gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës.

Andaj gjykata ka vlerësuar se është i pa kontestueshëm fakti se aktakuza e Prokurorit të Shtetit PP.nr.152/20 të datës 25.01.2020 është parashkruar me datë 22.10.2022, ndaj të pandehurës, pasi kanë kaluar 4 vite nga koha e kryerjes së veprës penale me datë 22.10.2018, e për të cilën është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në 1 vit sipas kodit të aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale ( Kodi nr. 04/L-129).

Me dispozitën ligjore të nenit 106 par.1 pika 1.6 të KPRK-së është paraparë se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 2 vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një vitë burgim ose me gjobë. Ndërsa dispozita ligjore e nenit 107 par. 8 të KPRK-së ka përcaktuar se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 KPP-së.

Prandaj nga arsyet e cekura me lartë gjykata ne kuptim te nenit të nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2020:011767, 10.05.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

---

**Edona Berisha Kastrati**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

---

**Musë Povataj**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 10 ditësh pas marrjes, gjykatës se Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj gjykate.